



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 244, dt. 04.11.2016

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 04.11.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e Projektit për ndërtimin e HEC-eve “HEC-I Vranisht, HEC-2 Stropan, HEC-Hocisht dhe HEC-4 Grapsh”, Bilisht Korçë, me subjekt aplikues “BEGEM ENERGJI” sh.p.k.
2. Shtyhet vendimmarrja për HEC-Zicisht, Bilisht Korçë.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR
ARTA DOLLANI

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

